

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5617
E enjte, 1 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

S'ka pajtim rreth
rezolutës për dialogun
me Serbinë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**GASHI: PO PUNOJMË QË
KOSOVA TË BËHET ANËTARE
E UNESCO-S NË VITIN 2019**

F. 13

**QEVERIA E HAPUR PËR
TË GJITHA TEMAT QË
ADRESOHEN NGA KOMUNAT**

F. 7

**KDI-ja U BËNË THIRRJE
PARTIVE QË T'I BASHKËREN-
DOJNË DRAFT-REZOLUTAT E
PROPOZUARA** F. 3

EKONOMI

**QEVERIA E KOSOVËS
MIRËPRET RAPORTIN E
BANKËS BOTËRORE PËR TË
BËRIT BIZNES 2019** F. 9

**BQK-JA SHËNON DITËN
BOTËRORE TË KURSIMEVE** F. 9

KULTURË

**PROF. DR. MUHAMED
KËRVESHI, NJËRI NGA
KRIJUESIT MË SERIOZ TË
LETËRSISË SONË** F. 13

Prof. dr. Shyqri GALICA

SPORT

**FERONIKELI E RUAN
KRYESIMIN, BALLKANI
BEFASOI LLAPIN** F. 14

**ISMAJLI LË KOSOVËN PËR
SHQIPËRINË** F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", LIRAK ÇELAJ

Asnjëri prej vendeve kryesore të BE-së nuk e kundërshton liberalizimin



Zëvendësministri i Integritimit Evropian, Lirak Çelaj, ka bërë me dije se deri më tani asnjëri prej vendeve kryesore të Bashkimit Evropian nuk është pozicionuar kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë inter-

vistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se disa prej këtyre vendeve kanë shprehur vetëm disa dilema në lidhje me këtë proces. Megjithatë, Çelaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke punuar me këto vende për t'ua larguar çdo

hamendje. Ai ka shprehur optimizëm se vendimmarrja e BE-së për këtë çështje do të ndodhë brenda këtij viti. Zëvendësministri Çelaj ka thënë se Kosova i ka kryer obligimet sa i përket plotësimit të kriterëve për liberalizimin e vizave

BE-ja kërkon miratimin e projektligjeve për sundimin e ligjit

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Natalya Apostolova, ka kërkuar progres konkret në legjislacionin që ka të bëjë me sundimin e ligjit. Ajo ka bërë thirrje që Kuvendi sa më shpejt ta miratojë Kodin Penal, Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme | FAQE 7



Qalaj kërkon ngritje të disiplinës dhe të integritetit policor | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti Thaçi në Bjellorusi: Marrëveshje për njohje reciproke e paqe në Ballkan

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë në Konferencën e Sigurisë në Minsk, se marrëveshja duhet të jetë për normalizim dhe pajtim në mes të dy vendeve dhe dy popujve. "Një marrëveshje, e cila është e obligueshme ndërkombëtarisht në mënyrë ligjore. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila nënkupton njohjen e dyanshme në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë presidenti Thaçi

BJELLORUSI/MINSK, 31 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në adresimin e tij para të pranishmëve në Konferencën e Sigurisë së Munihtut, që po i zhvillon punimet në Minsk të Bjellorusisë, ka thënë se tash është koha për marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi i ka falënderuar nikoqirët dhe Qeverinë e Bjellorusisë për mikpritjen dhe organizimin e kësaj konference. "Jam i lumtur që jam në Bjellorusi, vizita e parë e një niveli të tillë në mes të dy vendeve", ka thënë presidenti Thaçi, duke u fokusuar më pas në procesin nëpër të cilin po kalojnë Kosova dhe Serbia, në

kërkim të një marrëveshjeje paqjeje dhe pajtimi. "Bota ka ndryshuar. Evropa është në udhëkryq, me zhvillime të shumta të cilat shtrojnë pikëpyetje për të ardhmen. Ballkani Perëndimor ka mbetur i lënë në një situatë të paqartë. Në këtë realitet, Kosova dhe Serbia e gjejnë veten në kërkim të një marrëveshjeje përfundimtare paqjeje. Jemi duke i shqyrtuar të gjitha idetë. Sa i përket marrëveshjes, për asgjë nuk jemi marrë vesh ende". Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë është e vështirë, u shpreh presidenti Thaçi "por, edhe në rrethana të tilla unë shoh dritë në fund të tunelit. Pse?

Fillimisht, të dy shtetet, për këtë jam i bindur, e dinë se nuk mund të vazhdojnë të qëndrojnë ashtu siç janë sot. Status quoja e tanishme nuk mund të mbahet më. Konflikti i tanishëm i ngrirë i dëmton të dyja vendet në të gjitha fushat e jetës, në integritet, zhvillim ekonomik, në siguri", tha ai. Kreu i shtetit ka thënë se dialogu ka marrë mbështetje, por edhe disa kritika në vendet tona dhe ndërkombëtarisht. "Nuk kam problem me këtë. Ishte e pritshme. Kritikant janë të shëndetshme për debatën e përgjithshme, por edhe për vetë procesin. Posaçërisht, për një transparencë më të madhe dhe për përgjegjësi më të madhe të liderit, në të dy vendet. Në këtë proces, gjëja më e lehtë është të kritikosh dhe gjëja më e vështirë është ta gesh mënyrën për të arritur deri te marrëveshja. Duke arritur marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, do të kemi më pak populizëm në rajonin tonë, më pak nacionalizëm, më pak zëra që thërresin për luftë dhe tragjedi, më pak urrejtje dhe hakmarrje", u shpreh ai.

Presidenti Thaçi shtoi se qëllimi

kryesor i procesit të dialogut është arritja e një marrëveshjeje përfundimtare paqësore për njohje të ndërsjellë dhe ulëse të Kosovës në Kombet e Bashkuara. "Marrëveshja duhet të jetë për normalizim dhe pajtim në mes të dy vendeve dhe dy popujve. Një marrëveshje, e cila është e obligueshme ndërkombëtarisht në mënyrë ligjore. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila nënkupton njohjen e dyanshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pa njohje, kjo dhe çfarëdo marrëveshje tjetër nuk do të ketë kuptim. Marrëveshja duhet të jetë përfundimtare, jo e përkohshme. Duhet të jetë një marrëveshje, e cila do t'u sjellë më shumë rehati fqinjëve tanë dhe mbarë rajonit. Më lejoni të jem shumë i qartë rreth pikës së mëposhtme: nuk do të ketë kufij përgjatë vijave etnike dhe nuk do të ketë shkëmbim të popullatës në mes të dy vendeve. Do ta ruajmë shpirtin shumetnik dhe realitetin e Kosovës dhe Serbisë", ka thënë presidenti Thaçi.

Në Konferencën e Sigurisë së Munihtut, që po i zhvillon punimet në Minsk të Bjellorusisë,

presidenti i vendit ka thënë se tani është momenti i duhur për të vepruar drejt arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi. "Çfarë të mirash do të sjellë marrëveshja për dy vendet dhe më gjerë? Kosova dhe Serbia do ta njohin njëra-tjetrën. Të dy vendet do të kenë një perspektivë më të qartë dhe më të sigurt evropiane. Do të prodhojmë më shumë paqe për rajonin. Energjitë tona do të fokusohen në zhvillim, ekonomi, edukim, integritet dhe bashkëpunim. Kosova do të njihet nga pesë shtetet e BE-së të cilat nuk e njohin ende. Kur Serbia ta njohë Kosovën, askush nuk do të mund të bëhet më serb se Serbia dhe të vazhdojë të mos e njohë Kosovën ose ta bllokojë Kosovën në Këshillin e Sigurimit", ka pohuar presidenti Thaçi. Presidenti Thaçi e ka përfunduar fjalimin duke thënë se kemi nevojë për mbështetjen e secilit për të pasur sukses. Ai ka thënë se lideri në Kosovë dhe Serbi e dëshiron një marrëveshje të paqes, BE-ja e dëshiron dhe po punon drejt arritjes së kësaj marrëveshjeje dhe tani, pa hamendje, të gjithë duhet të lëvizim përpara.



Kryeministri i Izraelit shtyn vizitën në Tiranë

TIRANË, 31 TETOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu ka shtyrë për disa javë vizitën e tij në Shqipëri, e planifikuar për sot (e enjte).

Shkak për këtë shtyrje mësohet të jetë vdekja e një prej bashkëpunëtorëve të Netanyahu në qeverinë e tij, David-Azoulai, ministrit për Shërbimet Fetare.

David-Azoulai, 64 vjeç, ka qenë prej 22 vitesh një mbështetës i fortë i kryeministrit Netanyahu, i cili për herë të parë kishte marrë një post ministrior, si ministër për Shërbimet Fetare. Burime pranë qeverisë thanë se nuk ka anulim të vizitës së kryeministrit izraelit, por vetëm një shtyrje të saj, vizitë e cila pritet të realizohet brenda këtij viti.

Mediet izraelite kishin njoftuar se kryeministri Netanyahu do të vizitonte Tiranën më 1 nëntor, për herë të parë një vizitë e nivelit të lartë të shtetit izraelit.

"Zyra e kryeministrit, ka theksuar se do të vizitohet Tiranën më 1 nëntor dhe se Netanyahu do të marrë pjesë në një samit rajonal që do të zhvillohet në Shqipëri në fillim të muajit tjetër", shkruan

mediet e Izraelit.

Netanyahu do të qëndronte, sipas agjendës së kryeministrit izraelit, një ditë në Shqipëri dhe më pas do të udhëtonte ditën tjetër drejt Bullgarisë, ku në Sofje do të takohet me liderët e Greqisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe Serbisë.

Shtypi vendas e cilëson një vizitë të rëndësishme atë të



Netanyahu në Tiranë, duke konsideruar lidhje historike dhe miqësore mes dy vendeve, pavarësisht se Shqipëria është një shtet me shumicë myslimane.

S'ka pajtim rreth rezolutës për dialogun me Serbinë

Me qëndrime të kundërta në mes të pozitës dhe opozitës është mbajtur të mërkurën seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga LDK-ja në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pavarësisht prej thirrjeve të përfaqësuesve të pushtetit për harmonizimin e një rezolute të përbashkët për dialogun me Serbinë, përfaqësuesit e opozitës nuk janë pajtuar në këtë çështje me partitë në pushtet

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka filluar të mërkurën seancën e jashtëzakonshme "Debat parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të Kosovës për përfshirjen e 'shkëmbimit të territoreve' apo 'korrigjimit të kufijve' në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë". Për mbajtjen e kësaj seance u vendos në Kryesinë e Kuvendit, pas kërkesës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të mbështetur nga 42 deputetë. Në emër të LDK-së shefi i grupit parlamentar, Avdullah Hoti, ka kërkuar në fillim të seancës mbështetjen e deputetëve për të miratuar një rezolutë me të cilën presidentit Hashim Thaçi do t'i pamundësohej të negociojë me Serbinë çështjen e kufirit të Kosovës. Ai ka thënë se qasja e presidentit që në negociatë me Serbinë të diskutohet çështja e kufirit është jokushtetuese dhe e dëmshme. Hoti ka thënë se presidenti Thaçi është duke mashtruar kur thotë se ka mbështetjen ndërkombëtare për idenë e korrigjimit të kufijve. Ai e ka quajtur korrigjimin e kufijve ide të Beogradit dhe Moskës për ta penguar zhvillimin dhe fuqizimin e subjektivitetit të shtetit të Kosovës. "Dëmet tani janë bërë për këto veprime të presidentit. E para, është krijuar pasiguri e madhe qytetare, ekonomike dhe sociale si asnjëherë më parë. Vlerësimet tregojnë se pakënaqësia e qytetarëve ka arritur nivelin rekord, me mbi 80 për qind të qytetarëve që janë të pakënaqur me rrjedhat politike në Kosovë. E dyta, janë

stopuar të gjitha aktivitetet e diplomacisë të Kosovës dhe të shteteve mike për konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Është e qartë se këto veprime të presidentit janë antikushtetuese", ka deklaruar Hoti.

LDK-ja ka propozuar që dialogu me Serbinë të vazhdojë pas shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme dhe pas formimit të institucioneve të reja të Kosovës. "Rezoluta nuk ka për qëllim ndalimin e dialogut. Dialogu duhet të vazhdojë, pas zgjedhjeve të reja, nga institucione legjitime, që flasin në emër të shumicës së qytetarëve të Kosovës dhe dialog që bazohet në parime të qarta dhe vija të kuqe", ka thënë Hoti.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar që të gjitha subjektet politike së bashku të ulen dhe të krijojnë një rezolutë, platformë për dialog. Veseli u shpreh se nëse arrihet një konsensus dhe subjektet politike ulen së bashku për të dalë me një qëndrim të përbashkët atëherë, sipas tij, edhe presidenti Hashim Thaçi do të respektojë çdo pikë të rezolutës që do të mund të votohej për dialogun me Serbinë. "Ejani ulemi bashkërisht edhe një herë. Ndahen grupet parlamentare, ulen dhe konsumojnë debatin, krejt deputetët flasin, deri në fund për mos t'i mbetur borxh askujt, por ajo çka është kryesore, një marrëveshje duhet ta kemi sot. T'i dërgojmë një mesazh një të riu në Kosovë, një ndërmarrësi në Kosovë, një partneri të Kosovës, se Kosova e ka një qëndrim", ka thënë Veseli.

Edhe kryeministri Ramush



Haradinaj ka bërë thirrje për kompromis. "Një prej temave që kemi nevojë të gjejmë momentin për të thënë atë që mendojmë të gjithë bashkë është çështja e dialogut me Serbinë. Po ashtu, nuk ka dilemë që Kuvendi i Kosovës është autoriteti suprem, pa të cilin asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të jetësohet. Këtë duhet ta dimë të gjithë", ka thënë Haradinaj.

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili është emëruar nga Qeveria për ta udhëhequr ekipin negociator të Kosovës, ka thënë se kërkesa e ekzekutivit për t'u bërë bashkë, nga opozita duhet të shihet si nivel i ngritur i përgjegjësive. "Qeveria e Kosovës nuk ka nevojë që të vijë dhe ta lusë Kuvendin për të

zhvilluar negociatë. Por, kjo çfarë ne po bëjmë sot, po duam një format tjetër, që të jemi të përgjegjshëm, sepse nuk ka pasur nevojë të vijmë këtu për të kërkuar as votë, as asgjë për të zhvilluar negociatë sikur që ka ndodhur në të kaluarën, por rezultatet i kemi keq. Qeveria e përgjegjshme e Kosovës po dëshiron, ka dëshirë, duhet që Parlamenti i Kosovës, të gjitha grupet, të jemi bashkë dhe ky proces të jetë edhe transparent, edhe i përgjegjshëm dhe në fund me rezultat pozitiv", ka deklaruar Limaj.

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se presidenti Hashim Thaçi është duke u sjell si monark në raport me idenë për korrigjimin e territorit me

Serbinë. Ai gjatë debatit parlamentar për dialogun ka thënë se faza finale e këtij procesi ka përfunduar në vitin 2008.

Konjufca ka thënë se për këtë finale Serbia është ankuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ku kjo gjykatë i kishte dhënë të drejtë Kosovës për shpalljen e pavarësisë. Konjufca ka thënë se me një pikë të rezolutës duhet t'i kufizohet Hashim Thaçit çfarëdo takimi me zyrtarët e Serbisë.

Deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se Kosovës aktualisht nuk i duhet rezolutë, por platformë për bisedime. Molliqaj ishte kritik si ndaj opozitës ashtu edhe ndaj Qeverisë. Kjo seancë është zhvilluar me debat akuzash mes deputetëve të pozitës dhe të opozitës.

KDI-ja u bënë thirrje partive që t'i bashkërendojnë draft-rezolutat e propozuara

PRISHTINË, 31 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) përmes një reagimi për media ka njoftuar se është duke i përcjell zhvillimet në Kuvendin e Kosovës lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi. "KDI ka analizuar të gjitha draft-rezolutat e prezantuar deri më tani nga partitë në pushtet dhe ato në opozitë dhe vlerëson se përmbajtja e tyre përputhet në disa

pika siç janë: kërkesat për respektim të integritetit territorial të Republikës së Kosovës, kërkesa për njohje nga Serbia dhe përcaktimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës si autoriteti përfundimtar që do ta ratifikojë marrëveshjen e re potenciale me Serbinë", është thënë në reagimin e KDI-së. Sipas KDI-së, partitë politike duhet t'i bashkërendojnë këto kërkesa në një draft-

rezolutë të përbashkët. "Republika e Kosovës nuk duhet ta vazhdojë fazën finale të dialogut pa një qëndrim shtetëror të artikuluar në Kuvend, pa strategji dhe pa përcaktuar temat e diskutimit, vijat e kuqe, afatet kohore, pritshmëritë e palës kosovare në këtë proces dhe pa legjitimuar me anë të një rezolute ekipin udhëheqës të Kosovës në këto bisedime", thuhet në këtë

reagim.

KDI-ja ka vlerësuar se partitë parlamentare duhet t'i nisin përpjekjet e tyre për të ndërtuar konsensus politik dhe të artikulojnë qartazi qëndrimet e shtetit të Kosovës në këto bisedime. "Kuvendi i Kosovës duhet të marrë përgjegjësi në këtë proces dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të vullnetit të popullit, nuk mund të

shmangen nga përgjegjësitë që lidhen me të ardhmen e procesit. KDI-ja u bënë thirrje të gjitha partive politike në Kuvend që të angazhohen për këtë proces shtetëror duke luajtur një rol më konstruktiv dhe më të përgjegjshëm, duke lënë mënjanë politikën ditore dhe kalkulimet politike", është theksuar në reagimin e KDI-së.

Flet për "Epokën e re", Lirak Çelaj

Asnjëri prej vendeve kryesore të BE



Zëvendësministri i Integrimit Evropian, Lirak Çelaj, ka bërë me dije se deri më tani asnjëri prej vendeve kryesore të Bashkimit Evropian nuk është pozicionuar kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se disa prej këtyre vendeve kanë shprehur vetëm disa dilema në lidhje me këtë proces. Megjithatë, Çelaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke punuar me këto vende për t'ua larguar çdo hamendje. Ai ka shprehur optimizëm se vendimmarrja e BE-së për këtë çështje të ndodhë brenda këtij viti. Zëvendësministri Çelaj ka thënë se Kosova i ka kryer obligimet sa i përket plotësimin të kriterëve për liberalizimin e vizave

**EPOKA
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 31 TETOR - Zëvendësministri i Integrimit Evropian, Lirak Çelaj, ka shprehur optimizëm se Bashkimi Evropian brenda këtij viti do ta marrë vendimin për liberalizim të vizave për Kosovën. Ai ka bërë me dije se deri më tani asnjëri prej vendeve kryesore të BE-së nuk ka thënë se është kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Çelaj ka thënë se disa prej këtyre vendeve kanë shprehur vetëm disa dilema të cilat Qeveria po mundohet t'ua heqë. "Disa prej tyre na kanë konfir-

muar qëndrimin e tyre pozitiv për këtë çështje, ndërsa disa prej tyre kanë hapur mëdyshje, e kanë lënë si çështje të hapur. Sa kam informacione unë, deri më tani asnjëri prej këtyre vendeve nuk ka dalë kundër liberalizimit të vizave për Kosovën. Janë shprehur vetëm disa dilema dhe ne po përpiqemi t'i bindim dhe t'ua heqim këto dilema", ka thënë Çelaj.

Ai nuk ka dashur t'i përmendë emrat e vendeve që kanë shprehur këto dilema, duke shprehur optimizëm se Qeveria po punon me këto vende anëtare të BE-së në mënyrë që qëndrimi i tyre të jetë pozitiv. "Nuk mund t'i përmend në mënyrë specifike se cilat shtete kanë luhatur,

por ne po përpiqemi që shtetet më të mëdha të BE-së që kanë numrin më të madh të banorëve të kenë qëndrim pozitiv për këtë çështje. Mirëpo e mira së mirës është që të gjitha vendet të kenë qëndrim pozitiv", është shprehur Çelaj. Ai beson se vendimmarrja e BE-së për këtë çështje të ndodhë brenda këtij viti. "Shpresoj se vendimmarrja për këtë çështje të ndodhë brenda këtij viti por, për të qenë korrekt, meqenëse kjo nuk varet prej Kosovës drejtpërdrejt, nuk mund të them me saktësi se kur do të ndodhë. Shpresoj se vendimi pozitiv do të jetë brenda këtij viti", ka deklaruar Çelaj.

Zëvendësministri i Integrimit

-së nuk e kundërshton liberalizimin

"Epoka e re": Z. Çelaj, Kosova është në pritje të vendimit politik të BE-së, por çdoherë e më tepër po shtohet skepticizmi se kjo vendimmarrje nuk do të ndodhë brenda vitit?

Çelaj: Nuk ka të bëjë kjo me skepticizëm, por me të qenit korrekt karshi qytetarëve tanë, sepse po flasim për një vendim i cili nuk varet drejtpërdrejt nga Qeveria e Kosovës, sepse Qeveria e Kosovës i ka përmbushur të gjitha obligimet teknike që janë kërkuar nga BE-ja për procesin e liberalizimit të vizave. Ndërsa tash është një vendim politik i BE-së për të cilin disa vende anëtare të BE-së mund të kenë edhe hamendje politike, prandaj ne duhet të jemi korrektë dhe duhet t'u shmangemi datave apo ta paragjykojmë vendimin e BE-së. Kjo nuk do të thotë se ne jemi skeptikë për këtë vendim. Pra, ky është një vendim politik ku mund të ndikojnë shtetet e caktuara në këtë vendim për arsye të ndryshme, por ne si Qeveri jemi në pritje të këtij vendimi dhe shpresojmë se do të jetë pozitiv.

"Epoka e re": Çfarë ka bërë Qeveria kohën e fundit për t'i larguar hamendjet e këtyre vendeve anëtare të BE-së?

Çelaj: Ka pasur një varg veprimesh të ministrisë sonë, ku ministrja Hoxha ka pasur një varg takimesh me zyrtarët e lartë të shteteve anëtare të BE-së. Po ashtu, edhe zyrtarët e tjerë të Qeverisë dhe të Kuvendit kanë bërë përpjekje dhe lobim të vazhdueshëm duke u munduar të bindin nëse ndonjë shtet anëtar ka luhatje rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. Pra, të gjitha këtyre shteteve po u ofrojmë informata të mjaftueshme duke u argumentuar se ne jemi një shtet që meritojmë lëvizjen e lirë dhe se BE-ja është vonuar rreth kësaj çështje në raport me Kosovën. Kriteret që ne i kemi pasur për procesin e liberalizimit të vizave nuk i ka pasur asnjë shtet para nesh. Pra, Qeveria ka punuar dhe po punon duke lobuar për këtë çështje dhe tani na mbetet të shohim nëse ia kemi dalë t'i bindim ato shtete.

"Epoka e re": Në opinion publik përmenden disa shtete që janë skeptike rreth këtij vendimi. Është në dijeni Qeveria se cilat janë këto shtete apo sa është numri i tyre?

Çelaj: Nuk mund t'i përmend në mënyrë specifike se cilat shtete kanë luhatje, por ne po përpiqemi që shtetet më të mëdha të BE-së që kanë numrin më të madh të banorëve të kenë qëndrim pozitiv për këtë çështje. E mira e mirës është që të gjitha vendet të kenë qëndrim pozitiv.

"Epoka e re": Deri më tani këto shtete anëtare që kanë numrin më të madh të popullsisë në BE, ia kanë konfirmuar Qeverisë qëndrimet e veta për këtë çështje?

Çelaj: Disa prej tyre na e kanë konfirmuar qëndrimin pozitiv për këtë çështje, ndërsa disa prej tyre kanë lënë si çështje të hapur. Sa kam informacione, deri më tani asnjëri prej këtyre vendeve nuk ka dalë kundër liberalizimit të vizave për Kosovën. Janë shprehur vetëm disa dilema dhe ne po përpiqemi t'i bindim dhe t'ua heqim ato. Po e përsëris edhe një herë, se kjo çështje tanimë nuk është në dorën tonë, Kosova i ka kryer obligimet e veta dhe ne po e presim vendimin e tyre.

"Epoka e re": Sa është optimiste Qeveria që vendimmarrja për këtë proces të ndodhë brenda

këtij viti?

Çelaj: Shpresoj se vendimmarrja për këtë çështje të ndodhë brenda këtij viti, por për të qenë korrekt, meqenëse kjo nuk varet prej Kosovës drejtpërdrejt, nuk mund të them me saktësi se kur do të ndodhë. Shpresoj se vendimi pozitiv do të jetë brenda këtij viti.

"Epoka e re": Cili është roli i opozitës në këtë proces, sepse disa herë nga zyrtarët qeveritarë është thënë se dikush nga opozita po përçon mesazhe të tjera te vendet anëtare të BE-së?

Çelaj: Në vazhdimësi është thirrur për një unitet për temat kombëtare. Dhe meqenëse kjo është një prej çështjeve më të rëndësishme në raport me BE-në, do të duhej të ishim unikë. Mosuniteti mund të jetë një prej ndikuesve në këtë proces. Shpresojmë se nuk do të ndodhë kjo, por do të ndodhë që të gjithë,

pozitë dhe opozitë, të jenë unikë sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave.

"Epoka e re": Brenda çfarë kohe do të mund të dihet nëse vendimmarrja e BE-së do të ndodhë këtë vit apo do të shtyhet për vitin e ardhshëm?

Çelaj: Shpresoj dhe besoj se brenda këtij viti, pa specifikuar ndonjë muaj, do të ketë një vendim pozitiv të BE-së për këtë çështje.

"Epoka e re": Nëse eventualisht ndodh që të mos ketë vendimmarrje këtë vit, sa mendoni se do të shtyhet ky proces?

Çelaj: Varësisht se cili do të jetë vendimi i Këshillit të Ministrave të BE-së. Ata do të vendosin nëse do të shtyhet apo jo. Nuk po dua të paragjykoj asnjë vendim të këtij institucioni të BE-së për këtë çështje.

Qalaj kërkon ngritje të disiplinës dhe integritetit policor

PRISHTINE, 31 TETOR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (PK-së), Rashit Qalaj, ka mbajtur të mërkurën një takim zyrtar me menaxhmentin policor të Policisë së Kosovës, në të cilin kanë marrë pjesë drejtorët e departamenteve, drejtorët e divizioneve, drejtorët rajonalë, komandantët e stacioneve policore si dhe përfaqësues nga ICITAP-i amerikan. Ky takim zyrtar ishte i një rëndësie të veçantë, me fokus realizimin e objektivave strategjike të Policisë së Kosovës, menaxhimin sa më efikas policor, në veçanti u potencua dhe u kërkuar ngritja e disiplinës, performancës dhe

integritetit policor. Po ashtu, u diskutuan edhe çështjet kyçe që kanë të bëjnë me sigurinë e përgjithshme në vend, sigurinë e qytetarit, bashkëpunimin dhe takimet me komunitetin, luftën kundër korrupsionit, sigurinë në trafik, parandalimin e veprave kriminale, si vjedhjet, grabitjet, drogat, trafikimi i qenieve njerëzore etj. Nga stafi menaxherial u kërkuar të angazhohen edhe më shumë në të gjitha nivelet policore, në veçanti kur ka zhvillime apo procese mjaft të rëndësishme për vendin, në mënyrë që të krijohet një klimë edhe më e qetë dhe më e sigurt për të gjithë qytetarët, e që kontribuon edhe

në sigurinë e përgjithshme të vendit.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka theksuar se përmes vlerësimit të performancës së zyrtarëve policorë, përmes menaxhimit sa më efikas të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike, mund të arrihen rezultate edhe më pozitive në shumë sfera policore. Ky takim, i cili ishte i një përbërje mjaft të gjerë, rezultoi me zotimin për angazhime shtesë nga të gjithë të pranishmit, me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve policore të cilat janë në interes të qytetarëve dhe të vendit.



Evropian ka vlerësuar se Kosova i ka kryer të gjitha obligimet në këtë proces dhe se gjithçka është në duart e vendeve anëtare të BE-së. "Tash është një vendim politik i BE-së për të cilin disa vende anëtare të BE-së mund të kenë edhe hamendje politike, prandaj ne duhet të jemi korrektë dhe duhet t'u shmangemi datave apo ta paragjykojmë vendimin e BE-së. Kjo nuk do të thotë se ne jemi skeptikë për këtë vendim. Pra, ky është një vendim politik ku mund të ndikojnë shtetet e caktuara në këtë vendim për arsye të ndryshme, por ne si qeveri jemi në pritje të këtij vendimi dhe shpresojmë se do të jetë pozitiv", ka thënë Çelaj.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka mbajtur ligjëratë për studentët e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Gashi: Po punojmë që Kosova të bëhet anëtare e UNESCO-s në vitin 2019

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në një ligjërate për studentët e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ka bërë me dije se po bëhet punë e madhe për përbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në mënyrë që në vitin 2019 Kosova të mund të bëhet anëtare me të drejta të plota në UNESCO



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 TETOR - Nën organizimin e Organizatës Studentore Reforma dhe Këshillit të Studentëve të Fakultetit Filozofik, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka mbajtur të mërkurën një ligjëratë të hapur me studentët e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Tema të cilën ministri Gashi e ka trajtuar para studentëve ishte "Trashëgimia kulturore e Kosovës dhe UNESCO". Në kuadër të kësaj teme, ministri Gashi fillimisht ka shpalosur aktivitetet që ministria të cilën ai e drejton është duke bërë në aspektin e ruajtjes dhe promovimit të monumenteve të cilat pasqyrojnë vlerat e mirëfillta të trashëgimisë kulturore të

Kosovës. Si hap të rëndësishëm drejt realizimit të këtij qëllimi, ministri Gashi e cilësoi përgatitjen e draft-ligjit të ri për trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës, i cili pritet që në një të ardhme sa më të afërt ta marrë edhe miratimin e Kuvendit.

Ndërsa gjatë diskutimit të çështjes së aplikimit të Kosovës për anëtarësim në UNESCO, ministri Gashi ka thënë se është duke u bërë një punë e madhe për përbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në mënyrë që në vitin 2019 Kosova të mund të bëhet anëtare me të drejta të plota në UNESCO. "Në koordinim edhe me dikasteret e tjera që ndërlihen me çështjen e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, siç janë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, si dhe

Ministria e Punëve të Jashtme, jemi duke u angazhuar maksimalisht si në aspektin e përbushjes së obligimeve tona ndërinstitucionale, po ashtu edhe në aspektin e lobimit të vendet anëtare të UNESCO-s në mënyrë që të arrihet një përkrahje sa më e madhe dhe Kosova at kalojë me sukses procesin e votimit që do të mbahet në vitin 2019 dhe të bëhet anëtare me të drejta të plota në UNESCO", ka thënë ministri

Gashi. Në përfundim të ligjëratës së tij, ministri Gashi u dha hapësirë edhe studentëve të pranishëm që me komentet apo pyetjet e tyre të jenë pjesë aktive e kësaj ligjërate. Studentët, duke e vlerësuar të suksesshme punën e ministrit Gashi, përmes pyetjeve të tyre arritën të ngrehnin për diskutim shumë çështje të rëndësishme dhe me interes rreth trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Gjatë kësaj ligjërate, ministrit i kërkuan studentët që të përkraheshin ideja që brenda hapësirave të kompleksit universitar të bëhet një muze në të cilin do të vendoseshin artefakte dhe monumente të ndryshme që pasqyrojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës, të cilën ministri Gashi e mirëpriti dhe u zotua se në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta do ta jap maksimumin për realizim të kësaj ideje.

Qeveria e hapur për të gjitha temat që adresohen nga komunat

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - "Buxheti për komunat për vitin 2019 parashihet të jetë 531 milionë euro, 40 milionë euro më shumë nga viti i kaluar. Nga këto mjete mbi 14 milionë euro më shumë janë paraparë për fushën e arsimit dhe mbi 4 milionë euro më shumë për atë të shëndetësisë. Na presin edhe shumë punë të tjera të përbashkëta, por ky është veprimi i duhur i radhës, pjesë e zotimit tonë për të vendosur një bashkëpunim të mirë në mes të Qeverisë dhe komunave, në të mirë të qytetarëve tanë", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në takim të punës me kryetarët e komunave, në kuadër të "Forumit konsultativ qeveri - komuna". Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka thënë se nga puna e përbashkët e këtij forumi është arritur që nga Qeveria të kuptohen veprimet që mund të ndërmerren, të cilat do të jenë të dobishme për punën e komunave. Kryeministri Haradinaj ka thënë se në fillim kanë identifikuar ato që kanë të bëjnë me aspektin e pronave, të buxhetit e deri te procedurat e prokurimit. "Gjatë kësaj periudhe të përbashkët janë marrë mbi 50



vendime që lidhen me pronat, zonat ekonomike dhe shpronësimet në këtë periudhë, po ashtu janë aprovuar tri ligje: Për dhënien në shfrytëzim të pronës, trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Ligji për Prishtinën; Ligji për Obiliqin, dy koncept-dokumente për financat e pushtetit lokal dhe teatrot; vendime që lidhen me zonat ekonomike, parqet e biznesit, si Zona Ekonomike Amerikane, Parku Inovativ dhe Trajnues në Prizren; 30 shpronësime të pronave

me interes të komunave dhe afro 30 vendime për bartjen e pronave të komunat", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se është vazhduar me kornizën buxhetore 2019-2021 dhe se duhet të shfrytëzohet rasti sot, që të gjenden mënyrat për t'i kryer punët që presin dhe Qeveria do të jetë në përkrahje të vazhdueshme për të gjitha komunat për projektet zhvillimore që kanë. Haradinaj ka thënë se tema që është me rëndësi të madhe dhe që

ka të bëjë me marrëdhëniet e komunave me investitorët, të cilat kanë menduar që huaja nga ta të merret direkt dhe të drejtohet në projekte, tani, në bazë të Ligjit për financa, huaja duhet të merret nga niveli nacional, por projektet nuk ndryshohen. "Prandaj, nga ky takim, nga niveli nacional që është prezent këtu, duhet të dëgjohen me vëmendje temat që lidhen me sektorin financiar dhe të kujdesen në të ardhmen për ju, për komunat", ka thënë Haradinaj.

Disa prej çështjeve që janë ngritur dhe diskutuar nga kryetarët e komunave, për të cilat u kërkua zgjidhje dhe ndihmë nga Qeveria e Kosovës, ishin ato të huave financiare; vendimi për ndaljen e ngrohjes me thëngjill; çështja e pronës komunale, për të cilën u tha se ky vendim i Qeverisë ka lehtësuar shumë punën e komunave në mirëfunksionim; pastaj thjeshtësimi i procedurave burokratike për hapje të bizneseve; shërbimet shëndetësore; çerdhet e reja; menaxhimi i pyjeve; kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore; uji i pijes; impiantet e ujërave; dhe çështje me rëndësi vitale për qytetarët e Kosovës.

Kryeministri Haradinaj ka shprehur mbështetjen e Qeverisë për të gjitha çështjet e adresuara nga kryetarët e komunave, për tejkalimin e tyre, duke kërkuar përsheptimin e përmbylljes së punëve të filluara. Pas këtij takimi, kryeministri Haradinaj, në një konferencë për media, me disa prej kryetarëve të komunave ka theksuar se kjo Qeveri është e hapur për të gjitha temat që adresohen nga komunat.

BE-ja kërkon miratimin e projektligjeve për sundimin e ligjit

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Natalya Apostolova, ka kërkuar progres konkret në legjislacionin që ka të bëjë me sundimin e ligjit. Ajo ka bërë thirrje që Kuvendi sa më shpejt të miratojë Kodin Penal, Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme. Apostolova ka paralajmëruar se në fund të nëntorit pritet të bëhet një vlerësim i miratimit të legjislacionit që lidhet me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

EPOKA
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 TETOR - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova, të mërkurën është prituri në takim të përbashkët nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion. Me këtë rast Apostolova ka kërkuar progres konkret në legjislacionin që ka të bëjë me sundimin e ligjit që aktualisht është duke prituri miratimin në Kuvend.

Përfaqësuesja e BE-së ka thënë se Kodi Penal, Projektligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligji për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe për Projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme do të duhej të miratohejshin më parë. Ajo ka bërë me dije se në fund të nëntorit pritet të bëhet një vlerësim i miratimit të legjislacionit që lidhet me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Kam pasur një diskutim konstruktiv me anëtarët e Komisionit Parlamentar të Kuvendit. Thesova nevojën për të bërë progres konkret i cili duhet të përqendrohet në legjislacionin e sundimit të ligjit që aktualisht është duke prituri miratimin në Kuvend. Ne bëmë thirrje për miratimin e Kodit Penal, Projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme", ka shkruar Apostolova në llogarinë e vet në "Twitter".

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri



Veseli, pas takimit të përbashkët me anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe përfaqësuesen e lartë të BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka thënë se për

Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e vendit, agjenda e integritet evropian është prioritet i cili nuk ndërlidhet vetëm me standardet apo kriteret të cilat

mund të jenë të momentit akut, por ka të bëjë me vetë perspektivën euroatlantike. Ai ka bërë me dije se aktualisht në procedurë të shqyrtimit nga ana e Komisionit për Legjislacion

janë katër projektligje të proceduara nga Ministria e Drejtësisë të cilat ndërlidhen me reformat në sistemin e drejtësisë, por që ende nuk janë proceduar në seancë.

Sipas Veselit, bëhet fjalë për Kodin Penal, Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së paluajtshme. "Kjo reformë në sistemin e drejtësisë dhe integrimet evropiane, pavarësisht prej dallimeve që mund t'i kemi në momente të caktuara, është çështje e cila duhet të na bashkojë", ka theksuar Veseli, duke shtuar se Kuvendi, përkatësisht Komisioni për Legjislacion, merr përgjegjësinë t'i procedojë këto projektligje gjatë këtij muaji. "Ideja është shumë e qartë, ne do të lëvizim drejt BE-së, do të përmbushim çdo kriter që ka të bëjë me agjendën e reformave evropiane. Ky ishte edhe zotimi që dhamë në komision. Përkrahja e Zyrës së BE-së është shumë e sinqertë dhe shumë e drejtpërdrejtë", është shprehur kryeparlamentari Veseli.

Kurse kryetarja e Komisionit për Legjislacion, Albulena Haxhiu, ka thënë se katër ligjet e përmendura janë në procedurë të shqyrtimit në komision, përkatësisht në grupe punuese dhe së shpejti pritet të procedohen tutje. Duke dhënë sqarime për secilin projektligj veç e veç, Haxhiu ka theksuar se duhet të kihet parasysh se komisioni që ajo drejton është mjaft i ngarkuar me punë dhe shqyrtimi i projektligjeve me procedurë të përsheptuar mund të përcillet me probleme në zbatimin e tyre.

U ndahen mirënjohje gazetarëve që kontribuuan për promovimin e sigurisë kibernetike

Prishtinë, 31 tetor (ER) - Në kuadër të konferencës për siguri kibernetike dhe privatësi, "Sfidat në hapësirën kibernetike", që është organizuar për nder të Muajit Ndërkombëtar të Sigurisë Kibernetike, UBT, në bashkëpunim me Cyber Security and Privacy, kanë ndarë mirënjohje për gazetarët

që kanë dhënë kontribut për trajtimin dhe promovimin e sigurisë kibernetike dhe privatësisë në Kosovë.

Gazetarët të cilëve u janë ndarë mirënjohje janë: Adriatik Kelmendi nga "KTV", Driton Beqiri nga "RTK", Shkurtë Berisha nga "RTV21", Herolind Beqaj nga "T7", Shkëmbim

Krasniqi nga "Epoka e re" dhe Ardian Alaj nga "PCworld Albanian". Gjatë raportimit në media ata trajtuan tematika të ndërlidhura me rëndësinë e sigurisë kibernetike si dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në ndryshimet globale ekonomike, digjitalizimin dhe trendet e fundit teknologjikë.



Reçica: MPMS-ja ka mision uljen e papunësisë

PRIZREN, 30 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka marrë pjesë në hapje të Panairit të Punës në Prizren, ngjarje e përbashkët e MPMS-së me Komunën e Prizrenit dhe GIZ-in gjerman. Ministri Reçica ka thënë se ky

panair synon të krijojë dhe ofrojë vende të reja të punës dhe të sjellë më afër punëdhënësit dhe punëmarrësit, për të mundësuar krijimin e kontakteve të ndërsjella. "MPMS-ja ka mision përkrahjen e krijimit të vendeve të reja të punës, uljen e papunësisë,

aftësimin profesional dhe orientimin në karrierë të të rinjve, t'i garantojë të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve, për çka ne tashmë kemi ndërmarrë disa veprime, posaçërisht nëpërmjet reformave për përmirësim dhe avancim të infra-

strukturës ligjore", ka deklaruar Reçica.

Sipas ministrit Reçica, me ndryshimet e domosdoshme ligjore po synohet jo vetëm rritja e punësimit, por edhe garantimi i të drejtave të punëtorëve. "Në këtë pikë unë dhe dikasteri që drejtoj

do të jemi gardian i mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të punëtorëve dhe u bëj thirrje të gjithë punëdhënësve dhe bizneseve t'i respektojnë të drejtat e punëtorëve të garantuara me legjislacionin në fuqi", është shprehur ministri Reçica.



Qeveria e Kosovës mirëpret raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes 2019

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 TETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka mirëpritur raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes për vitin 2019, të publikuar më 31 tetor 2017, ku Kosova vazhdon të ketë progres gradual në përmirësimin e mjedisit afarist dhe radhitet në vendin e dytë në rajon për lehtësinë e të bërit biznes.

Qeveria e Kosovës thekson përkushtimin që edhe më tutje ta vazhdojë punën në reformat e përgjithshme në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe fuqizim të sektorit privat dhe krijimit të një klime të favorshme për biznese dhe tërheqje të investimeve në



vendin tonë.

Qeveria e Kosovës thekson se vlerësimi i Kosovës dhe radhitja

e saj në këtë raport tregon se janë identifikuar përmirësime të konsiderueshme në tri fusha:

Sigurimi i lejeve të ndërtimit, ku ka pasur progres të konsiderueshëm duke përmirësuar radhitjen për 22 vende për shkak të reformave dhe përmirësimit të procesit të lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe procedurave të inspektimit të ndërtimeve; 2. Pagesa e tatimeve, ku Kosova ka bërë progres në lehtësimin e procedurave për rimbursimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar; 3. Tregtia përtej kufijve, ku është bërë progres në thjeshtësimin e procedurave të kontrollit doganor, mirëpo ky progres nuk është reflektuar në ngritje të madhe në radhitje.

Përkundër që është shënuar një rënie e lehtë në radhitje, Republika e Kosovës vazhdon të jetë shteti i dytë në shtetet e Ballkanit Perëndimor me mje-

disin më të mirë për të bërit biznes sipas raportit.

Që nga fillimi i procesit të reformave të bazuara në Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes, Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht ka theksuar rëndësinë e progresit gradual dhe të qëndrueshëm në përmirësimin e mjedisit afarist dhe përdorimin e kësaj metodologjie si platformë për identifikimin dhe implementimin e reformave rrënjësore që përmirësojnë lehtësinë e të bërit biznes në vendin tonë. Qeveria e Kosovës ka theksuar në vazhdimësi përkushtimin dhe do të vazhdojë t'i ndërmarrë reformat e duhura në mënyrë që Kosova të shënojë progres edhe më të madh dhe të konkurrojë me shtetet më efektive në këtë fushë.

Lekaj me Minxhozin: Shumë projekte të përbashkëta do të bëhen realitet së shpejti

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozin, me të

cilin kanë biseduar për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve. "Shumë projekte të përbashkëta Kosovë - Shqipëri, që do të bëhen realitet së shpejti, bised-

uam me ambasadorin e Shqipërisë në vendin tonë, Qemal Minxhozi. Krahas Vërmicës, edhe pikat e tjera kufitare duhet të lidhen me infra-

strukturë rrugore. Festa kombëtare, këtë 28 nëntor na gjen me lajme të mira", ka shkruar ministri Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".





Politikat e MBPZhR-së, në harmoni me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Objektiv i kryesor i politikave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është zhvillimi i bujqësisë sipas modelit evropian, një bujqësi e qëndrueshme dhe konkurruese. Krahas kësaj, MBPZhR-ja përmes investimeve synon ngritjen e kapaciteteve të fermerëve dhe agrobizneseve vendore, me qëllim që prodhimet të arrijnë t'i

plotësojnë standardet evropiane dhe të depërtojnë në tregjet e BE-së.

Kështu është shprehur të mërkurën zëvendësministri i MBPZhR-së, Mevludin Krasniqi, në konferencën "MSA, sfidat dhe problemet që ballafaqohen prodhuesit vendorë", të organizuar nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë (IADK). Me këtë rast, zëvendësministri

Krasniqi ka thënë se mbështetja e ministrisë dhe partnerëve ndërkombëtarë për bujqësinë e Kosovës ka sjellë produktivitet të lartë në sektorin e bujqësisë e bashkë me këtë edhe rritje të cilësisë së prodhimeve. "Në harmoni me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së, si dhe me legjislacionin në fuqi, MBPZhR-ja ka shënuar progres në këtë sektor dhe kemi bërë reforma

strukture që janë në përputhje me normat dhe standardet e BE-së. Po ashtu, angazhimin tonë jemi duke e vazhduar çdo ditë në mbështetje të bujqve, fermerëve dhe prodhuesve vendorë për t'ua lehtësuar sfidat me të cilat ballafaqohen ata. Madje investimet dhe përkrahja institucionale po shkon në ngritjen e cilësisë së produkteve, që është garanci që edhe produktet 'Made in

Kosova' të depërtojnë edhe në tregun rajonal dhe evropian", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se edhe eksporti i produkteve bujqësore në tregjet e huaja ka shënuar rritje nga viti në vit. Gjatë kësaj konference përfaqësuesit e IADK-së kanë prezantuar edhe sfidat me të cilat ballafaqohen fermerët, agrobizneset në punën e tyre e të cilat janë të ndërlidhura me MSA-në.



Delegacioni nga organizata Rumelisiad viziton Klubin e Prodhuesve

Prishtinë, 31 tetor (ER) - Përfaqësues të Klubit të Prodhuesve të Kosovës kanë mirëpritur të mërkurën në vizitë përfaqësueses të organizatës së afaristëve Rumelisiad, të ardhur nga qyteti i Bursës në Turqi.

Anëtarët e organizatës Rumelisiad janë sipërmarrës në Turqi të cilët janë me origjinë nga Ballkani, të cilët janë duke qëndruar në një vizitë dyditore në vendin tonë. Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me prodhuesit vendorë dhe krijimin e mundësive të reja për

bashkëpunim në të ardhmen.

Duke marrë parasysh potencialin e prodhimit të dyja palët synojnë zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bashkëpunuese në mes të prodhuesve kosovarë dhe atyre turq.

Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, u ka uruar mirëseardhje mysafirëve dhe i ka falënderuar për vizitën. Ai i ka njoftuar afaristët me punën e Klubit të Prodhuesve dhe me anëtarët e Klubit.

Edhe afaristët nga organizata

Rumelisiad shprehën kënaqësinë që u takun me Klubin e Prodhuesve dhe treguan që prej themelimit të tyre në vitin 2006 kanë qenë të pranishëm në Kosovë me projekte të shumta.

Gjithashtu, ata shprehën gatishmërinë që ky bashkëpunim të vazhdojë të rritet edhe në të ardhmen. Anëtarët e organizatës Rumelisiad po ashtu prezantuan profilet e anëtarëve të tyre, duke shikuar mundësitë e bashkëpunimit dhe duke shprehur interesim të investojnë në të ardhmen në vendin tonë.

BQK-ja shënon Ditën Botërore të Kursimeve

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për të tretin vit me radhë ka organizuar të mërkurën Ditën Botërore të Kursimeve. Pjesëmarrës në shënimin e kësaj dite kanë qenë nxënësit e Shkollës Filllore "Pavarësia" nga Prishtina, të cilët kanë shfaqur aftësitë e tyre rreth mënyrave të kursimit të parave, ashtu edhe përmes vizatimeve të ndryshme.

Edukimi dhe ngritja e njohurive financiare, që nga themelimi i BQK-së, kanë pasur gjithmonë vend të rëndësishëm, rrjedhimisht në vazhdimësi janë ndërmarrë aktivitete dhe realizuar projekte të shumta eduka-

tive. Këto aktivitete kanë pasur për target grupmosha të ndryshme, duke përfshirë studentët të universiteteve, nxënësit të shkollave të mesme dhe nxënësit të shkollave fillore.

Qëllimi i të gjitha këtyre aktiviteteve dhe projekteve është që BQK-ja të kontribuojë në ngritje të njohurive e dukativo financiare.

Dita Botërore e Kursimeve nga viti 1924 shënohet në mbarë botën nga shumica e institucioneve financiare. Në këtë datë institucione të ndryshme organizojnë aktivitete që për synim e kanë ngritjen dhe vetëdijen mbi rolin dhe rëndësinë e kursimeve.



Bekim Jashari kërkon që Ahmet Delia ta mbajë titullin 'Hero i Kosovës'

SKENDERAJ, 31 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se edhe pas një shekulli, heroi kombëtar Ahmet Delia është pa titullin e merituar "Hero i Kosovës". Jashari ka bërë me dije se i është drejtuar me një kërkesë zyrtare presidentit të vendit, Hashim Thaçi, që në bazë të kompetencave kushtetuese të tij t'i ndajë titullin "Hero i Kosovës", Ahmet Delisë. "Zyrtarisht i jam drejtuar presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, që në bazë të kompetencave kushtetuese, si President i Shtetit, t'i ndajë titullin 'Hero i Kosovës' Ahmet Delisë, një ndër figurat më të ndritura të historisë sonë kombëtare, udhëheqësit të kryengritjeve anti-osmane, nisimëtarit të kryengritjes së përgjithshme shqiptare në vitin 1912. Trimi Ahmet Delia ishte i pari që nisi rezistencën kundër pushtimit serb të Kosovës, në vjeshtë e po atij viti. Dhënia e titullit "Hero i Kosovës" për Ahmet Delinë, në prag të festave të nëntorit, është nderim për Drenicën dhe gjithë sakrificën e dëshmorëve të kombit shqiptar. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Jashari.



Fushata 'Dhuna nuk arsyetohet' mbahet në Pejë

PEJË, 31 TETOR (ER) - Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë (DPP), mbështetur nga Zyra Qendrore e OSBE-së në Prishtinë, kanë organizuar në Komunën e Pejës fushatën "Dhuna nuk arsyetohet". Të pranishëm në fushatë kanë qenë kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, drejtori Rajonal i Policisë në Pejë, kolonel Shaban Shala, kryeprokurori Agim Kurmehaj dhe zyrtarja e OSBE-së, Shpresa Mulliqi.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka thënë se dhuna është një fenomen i cili duhet të luftohet në shoqëri. "Dhuna në familje krijon dhunë edhe në shoqëri dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme, që të rinjtë të jenë promotorë që në familjet e tyre të angazhohen që me dashurinë e tyre të kontribuojnë që prindërit e tyre të kenë sjellje e cila i duhet shoqërisë. Një familje e shëndoshë është

themel i një shoqërie të shëndoshë, e cila kontribuon në mirëqenien dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi", ka thënë Muhaxheri. Fushata "Dhuna nuk arsyetohet" në Pejë ka vazhduar me ekspozitën e nxënësve të shkollës së mesme të arteve aplikative, me performancë artistike, me shpërndarjen e fletushkave nga Policia e Kosovës si dhe me shpërndarjen e materialeve informuese mbi dhunën.



Ushtarakë të lartë të KFOR-it vizituan kryetarin Bahtiri

MITROVICË, 31 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të mërkurën në një takim zëvendëskomandantin e Detashmenteve të Përbashkëta të KFOR-it në veri, Ervin Hartman, para se të largohet nga Kosova për shkak të përfundimit të misionit. Në takim ishte i pranishëm edhe pasuesi i tij në këtë detyrë, Mihael Plevnik. Ushtaraku i lartë i KFOR-it i ka thënë kryetarit Bahtiri se pati dëshirë që para se të kthehet në shtetin e tij, të takojë dhe falënderoj për bashkëpunimin e mirë që KFOR-i dhe ai personalisht ka pasur me Komunën e Mitrovicës. "Ju falënderoj shumë

për bashkëpunimin e ngushtë që kemi pasur dhe kontributin që keni dhënë për stabilizimin e gjendjes. Ju jeni duke bërë punë të mirë për Mitrovicën dhe qytetarët e saj. Besoj se bashkëpunimi juaj i mirë me KFOR-in do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka thënë ai. Kryetari Bahtiri ka falënderuar zëvendëskomandantin Hartman për punën e mirë që ai dhe KFOR-i kanë bërë në Mitrovicë, duke dhënë kështu kontributin e tyre për stabilizimin dhe përmirësimin e situatës të sigurisë gjatë realizimit të misionit në këtë rajon dhe në Kosovë. Kryetari Bahtiri e njoftoi ushtarakun e lartë të KFOR-it

edhe për zhvillimet aktuale në Mitrovicë e Kosovë, me ç'rast ka theksuar se vizioni i qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës është i çartë e ai është rruga drejt Bashkimit Evropian. "Kohët e fundit po flitet shumë edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Unë mund t'ju them se institucionet e Kosovës dhe qytetarët e saj janë për dialog, por pa i prekur kufijtë aktualë të shënuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, është qëndrim unanimit se edhe Asociacioni i Komunave Serbe të Kosovës nuk mund të ketë kompetenca që e dëmtojnë sovranitetin dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës", ka thënë Bahtiri.

Mbahet debati publik për draft-rregulloren për tokën bujqësore në Malishevë

MALISHEVË, 31 TETOR (ER) - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Malishevës ka mbajtur debatin publik me qytetarë, këshilltarë të Kuvendit Komunal të Malishevës, mbi draft-rregulloren për tokën bujqësore. Drejtori i kësaj drejtorie, Murat Hoxha, ka njoftuar se si drejtori së bashku me zyrtarët kanë hartuar draft-rregulloren për tokën bujqësore. Ndërsa zyrtari i kësaj drejtorie, Milaim Morina, ka prezantuar në hollësi këtë draft-rregullore, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin nr. 02/L26 për Tokën Bujqësore, Statutin e Komunës së Malishevës dhe Udhëzimin

Administrativ Nr. 10/2010 për ndërrim të tokës bujqësore. "Qëllimi i kësaj draft-rregullore është që t'i caktojë procedurat dhe kriteret e vendosjes për ndërrim të përhershëm ose të përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore. Procedurat e parapara kërkojnë në veçanti një bashkëpunim të ngushtë të organeve përkatëse kompetente për planifikimin hapësinor dhe bujqësi, përfshirë këtu edhe Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Malishevë", ka thënë Morina. Nga ata që janë inkuadruar në debat është kërkuar që toka bujqësore të ruhet, duke zbatuar ligjin në përpikëri.



Bekim Jashari kërkon që Ahmet Delia ta mbajë titullin 'Hero i Kosovës'

SKENDERAJ, 31 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se edhe pas një shekulli, heroi kombëtar Ahmet Delia është pa titullin e merituar "Hero i Kosovës". Jashari ka bërë me dije se i është drejtuar me një kërkesë zyrtare presidentit të vendit, Hashim Thaçi, që në bazë të kompetencave kushtetuese të tij t'i ndajë titullin "Hero i Kosovës", Ahmet Delisë. "Zyrtarisht i jam drejtuar presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, që në bazë të kompetencave kushtetuese, si President i Shtetit, t'i ndajë titullin 'Hero i Kosovës' Ahmet Delisë, një ndër figurat më të ndritura të historisë sonë kombëtare, udhëheqësit të kryengritjeve anti-osmane, nisimëtarit të kryengritjes së përgjithshme shqiptare në vitin 1912. Trimi Ahmet Delia ishte i pari që nisi rezistencën kundër pushtimit serb të Kosovës, në vjeshtë e po atij viti. Dhënia e titullit "Hero i Kosovës" për Ahmet Delinë, në prag të festave të nëntorit, është nderim për Drenicën dhe gjithë sakrificën e dëshmorëve të kombit shqiptar. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Jashari.



Fushata 'Dhuna nuk arsyetohet' mbahet në Pejë

PEJË, 31 TETOR (ER) - Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë (DPP), mbështetur nga Zyra Qendrore e OSBE-së në Prishtinë, kanë organizuar në Komunën e Pejës fushatën "Dhuna nuk arsyetohet". Të pranishëm në fushatë kanë qenë kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, drejtori Rajonal i Policisë në Pejë, kolonel Shaban Shala, kryeprokurori Agim Kurmehaj dhe zyrtarja e OSBE-së, Shpresa Mulliqi.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka thënë se dhuna është një fenomen i cili duhet të luftohet në shoqëri. "Dhuna në familje krijon dhunë edhe në shoqëri dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme, që të rinjtë të jenë promotorë që në familjet e tyre të angazhohen që me dashurinë e tyre të kontribuojnë që prindërit e tyre të kenë sjellje e cila i duhet shoqërisë. Një familje e shëndoshë është

themel i një shoqërie të shëndoshë, e cila kontribuon në mirëqenien dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi", ka thënë Muhaxheri. Fushata "Dhuna nuk arsyetohet" në Pejë ka vazhduar me ekspozitën e nxënësve të shkollës së mesme të arteve aplikative, me performancë artistike, me shpërndarjen e fletushkave nga Policia e Kosovës si dhe me shpërndarjen e materialeve informuese mbi dhunën.



Ushtarakë të lartë të KFOR-it vizituan kryetarin Bahtiri

MITROVICË, 31 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të mërkurën në një takim zëvendëskomandantin e Detashmenteve të Përbashkëta të KFOR-it në veri, Ervin Hartman, para se të largohet nga Kosova për shkak të përfundimit të misionit. Në takim ishte i pranishëm edhe pasuesi i tij në këtë detyrë, Mihael Plevnik. Ushtaraku i lartë i KFOR-it i ka thënë kryetarit Bahtiri se pati dëshirë që para se të kthehet në shtetin e tij, të takojë dhe falënderoj për bashkëpunimin e mirë që KFOR-i dhe ai personalisht ka pasur me Komunën e Mitrovicës. "Ju falënderoj shumë

për bashkëpunimin e ngushtë që kemi pasur dhe kontributin që keni dhënë për stabilizimin e gjendjes. Ju jeni duke bërë punë të mirë për Mitrovicën dhe qytetarët e saj. Besoj se bashkëpunimi juaj i mirë me KFOR-in do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka thënë ai. Kryetari Bahtiri ka falënderuar zëvendëskomandantin Hartman për punën e mirë që ai dhe KFOR-i kanë bërë në Mitrovicë, duke dhënë kështu kontributin e tyre për stabilizimin dhe përmirësimin e situatës të sigurisë gjatë realizimit të misionit në këtë rajon dhe në Kosovë. Kryetari Bahtiri e njoftoi ushtarakun e lartë të KFOR-it

edhe për zhvillimet aktuale në Mitrovicë e Kosovë, me ç'rast ka theksuar se vizioni i qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës është i çartë e ai është rruga drejt Bashkimit Evropian. "Kohët e fundit po flitet shumë edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Unë mund t'ju them se institucionet e Kosovës dhe qytetarët e saj janë për dialog, por pa i prekur kufijtë aktualë të shënuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, është qëndrim unanimit se edhe Asociacioni i Komunave Serbe të Kosovës nuk mund të ketë kompetenca që e dëmtojnë sovranitetin dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës", ka thënë Bahtiri.

Mbahet debati publik për draft-rregulloren për tokën bujqësore në Malishevë

MALISHEVË, 31 TETOR (ER) - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Malishevës ka mbajtur debatin publik me qytetarë, këshilltarë të Kuvendit Komunal të Malishevës, mbi draft-rregulloren për tokën bujqësore. Drejtori i kësaj drejtorie, Murat Hoxha, ka njoftuar se si drejtori së bashku me zyrtarët kanë hartuar draft-rregulloren për tokën bujqësore. Ndërsa zyrtari i kësaj drejtorie, Milaim Morina, ka prezantuar në hollësi këtë draft-rregullore, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin nr. 02/L26 për Tokën Bujqësore, Statutin e Komunës së Malishevës dhe Udhëzimin

Administrativ Nr. 10/2010 për ndërrim të tokës bujqësore. "Qëllimi i kësaj draft-rregullore është që t'i caktojë procedurat dhe kriteret e vendosjes për ndërrim të përhershëm ose të përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore. Procedurat e parapara kërkojnë në veçanti një bashkëpunim të ngushtë të organeve përkatëse kompetente për planifikimin hapësinor dhe bujqësi, përfshirë këtu edhe Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Malishevë", ka thënë Morina. Nga ata që janë inkuadruar në debat është kërkuar që toka bujqësore të ruhet, duke zbatuar ligjin në përpikëri.



E jashtëzakonshme

Zbulohet një tunel sekret nëntokësor në piramidën antike meksikane

Arkeologët kanë zbuluar një tunel misterioz dhe një dhomë funerale nën Piramidën e Hënës pranë qytetit të Meksikës, që besohet se përfaqëson një rrugë kalimi në botën e lashtë. Dhoma 15 metra e gjatë, e vendosur rreth 8 metra nën sipërfaqe, në qytetin antik të



Teotihuacan, besohet se është përdorur për ritualet e shenjta funerare. Dhoma dhe tuneli u zbuluan në vitin 2017, por rezultatet e studimit sapo janë publikuar.

BARSOLETA E DITËS



E ndalon polici vozitësin dhe i thotë:
- O jaran, është e katërta herë që po të ndali dhe po të them që diçka po të rrjedhë nga makina!
Vozitësi ia kthen:
- Edhe unë që kaq herë po të them se kjo është cisternë për pastrimin e rrugëve!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00




FOTO E DITES



Pamje të dy stinëve vjeshtë-dimër. Foto e realizuar në Pejë nga Granit Dinaj.

**Në ora 16:00
“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



E rrallë

Burgoset babai, ushqeu fëmijët vetëm me "Coca Cola"

Një baba është burgosur pasi ushqeu dy djemtë e vet, tre dhe katër vjeç, vetëm me "Coca Cola", ka bërë me dije avokatja e fëmijëve në Francë. "Babai, i cili nuk di të lexojë, të shkruajë apo të bëjë llogari, nuk e kupton seriozitetin e situatës dhe harxhoi të gjitha paratë e ndihmës sociale në alkool", ka thënë Carole Papon,



përfaqësuese e Shoqatës Viktima Franceze 87. Pasi mori ndihmën sociale, brenda disa ditësh familja nuk kishte asgjë për të ngrënë. "Ata kishin vetëm 'Coca Cola' për të pirë", ka thënë avokatja.



DASHI

Duhet të jeni sa më konstruktiv në raportet e reja që keni ndërmarrë së fundmi. Si nga ana afektive dhe ajo profesionale çdo gjë është në një linjë të re.



DEMI

Nëse nuk keni marrë një vendim të qartë sa i përket karrierës duhet të filloni të bëni ndarjet tuaja dhe t'i përcaktoni prioritetet.



BINJAKËT

Nuk duhet ta lejoni frikën tuaj të brendshme ta frenojë për të marrë vendime që në fund të ditës janë në të mirë të punës.



GAFORRJA

Edhe pse nuk doni të ndryshoni gjë nga rutina juaj e përditshme, po e kuptoni se shumë gjëra po ju pengojnë.



LUANI

Problemi juaj më i madh sot është përqendrimi. Nuk do të mund të përqendroheshi dot për asnjë çast.



VIRGJËRESHA

Sot për një kapriçio tuajën do të mund të rrezikoni një projekt shumë të rëndësishëm. Do të rregulloni gjithçka në fund.



PESHORJA

Nuk ju pëlqen të merrni vendime që nuk kanë asnjë pasojë për ju. Doni ose gjithçka ose asgjë.



AKREPI

Mos kini drojë të vini në pikëpyetje impenjimet që keni për sot. Nëse do ta bëni do të jetë për një arsye të mirë.



SHIGJETARI

Gjithmonë keni qenë aventurier dhe kjo ju ka sjellë veç gjëra të mira. E rëndësishme është të mos sakrifikoni shumë.



BRICJAPI

Duhet të hiqni dorë nga persona që kanë përfutur gjithmonë prej jush. Është mirë të jeni të vetëdijshëm për aftësitë tuaja.



UJORI

Rruga që po përshkoni ka shumë pengesa dhe ju e dini këtë gjë. Nuk doni të bëni kompromise për çështje të caktuara.



PESHQIT

Mos kini frikë të thoni hapur mendimin tuaj sot. Edhe pse nuk do të keni përkrahje, ajo që mendoni është e drejtë.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Një fjalë në akademinë letrare

Prof. dr. Muhamed Kërveshi, njëri nga krijuesit më serioz të letërsisë sonë



Prof. dr. Shyqri GALICA

Prof. dr. Muhamed Kërveshi është një emër i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare, i cili ndihmesën e tij e ka dhënë me shumë përkushtim e dashuri dekada të tëra. Ngritja e tij arsimore e intelektuale, kultura e gjerë që ka fituar brenda e jashtë atdheut, këtë personalitet e ka bërë të dallohet me punën dhe me veprën e tij si pedagog, studiues e mbi të gjitha shkrimtar. Pedagog me diapazon të gjerë, ligjërues i shkollës evropiane, duke sjellë

metodologji e përvijë pak a fare të njohur midis nesh, do t'u mundësojë brezave të rinj të njihen me realitetin e botës së qytetëruar dhe me njohuritë e gjuhës frënge, duke sjellë kështu dhe njohuri për kulturën arsimore e letrare të një vendi të veçantë evropian, Francës e më gjerë.

Mbase duke njohur mjaft mirë kulturën dhe letërsinë e traditës dhe atë moderne franceze, Prof. Kërveshi bën një punë në këtë fushë si asnjë tjetër - shqipëron e boton krijimet më të mira poetike nga gjuha frënge dhe u ofron lexuesve e intelektualëve tanë nëpërmjet botimeve të përditshme, periodike e në vëllime të veçanta vlera letrare-artistike, që ndihmojnë depërtimin në një fushë pak të njohur historike e aktuale të krijimtarisë. Duke qenë pedagog shumëvjeçar

në Universitetin e Prishtinës, prof. Kërveshi arriti të japë shumë nga përvoja e tij në Perëndim dhe t'u krijojë studentëve mundësinë për ta njohur më thellë realitetin historik e artistik të Francës dhe të mjedisve të ndryshme nëpërmjet gjuhës frënge dhe gjithësisht shqipërimeve e ligjërimeve të shumta.

Pos poezisë si vokacion parësor, Prof. Kërveshi është marrë edhe me studime e shkrime të tjera, të cilat figurën e tij e bëjnë më komplekse e më interesante edhe si krijues, edhe si studiues, edhe si intelektual.

Vargu i veprave të tij është i gjatë, mbase si rrallë ndonjë shkrimtar tjetër, siç janë të shumta edhe gjuhët në të cilat janë përkthyer krijimet e tij letrare e shkencore: slovenisht, serbokroatisht, rumanisht, ital-

isht, maqedonisht, turqisht, bullgarisht, hungarisht, slovakisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht, anglisht, persisht, rusisht, suedisht, polonisht, boshnjakisht etj.

Ka shkruar rreth gjashtëdhjetë vëllime poetike për të rritur dhe afër dhjetë për fëmijë, si dhe vepra të tjera, drama, ese, studime, që e bëjnë shumë të pasur veprimtarinë e tij. Profesori ynë ka shqipëruar rreth njëzet vepra nga frëngjishtja dhe ajo që vlen të theksohet posaçërisht, me krijimet e tij letrare është përfaqësuar në më shumë se gjashtëdhjetë antologji të ndryshme në vend dhe jashtë, që do të thotë se vlerësohet si njëri nga përfaqësuesit tanë më serioz i letërsisë sonë gjithandej. Edhe dy veprat që porsa kanë dalë nga shtypi, "Zanoret" dhe "Mërzia për

Mitrovicën" janë dëshmi e veçantë e artikullimit të historisë dhe të aktualitetit me shumë sens dhe me shqetësime që bartin dhe barrën e rëndë të këtij populli për liri. Këtë realitet e ka pikturuar me gjetje artistike dhe me nuanca që reflektojnë në një spektër që tejkalon mesazhin kombëtar.

Duke pasur parasysh këtë kontribut të jashtëzakonshëm të Prof. Kërveshit, mendojmë se ky krijues e intelektual ka herë është dashur të ishte midis akademikëve edhe formalisht, si dhe të nderohet me çmimet më të larta që jepen në nivel kombëtar, pavarësisht se shumë herë edhe është nderuar në raste të ndryshme.

Kjo akademi letrare (LShK, Pejë, 13.10.2018) nderon personalitetin e tij, por gjithësisht edhe LShK-në dhe letërsinë tonë përgjithësisht.


Qeveria miraton dy rregullore për të drejtën e autorit

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës u miratuan dy rregullore që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit dhe pronën intelektuale të cilat duhet të mbrohen me ligj. Bëhet fjalë për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për ndërmjetësimin e të Drejtës së Autorit dhe Rregulloren për të drejtën e kompensimit të veçantë. Në ekspozenë e tij, ministri Kujtim Gashi ka thënë se rregullorja e ndryshuar dhe plotësuar siguron që procesi i ndërmjetësimin në të drejtën e autorit të zhvillohet në mënyrë efikase. "Ajo përcakton afate dhe procedura të qarta dhe të sakta, në këtë aspekt rritë sigurinë juridike dhe ndihmon në zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta", ka thënë Gashi.

Ai ka shtuar se me këtë rregullore janë trajtuar çështjet kryesore si në vijim: Çështja e fillimit të procedurës së ndërmjetësimin në kontestet e përcaktimit të tarifave të përgjithshme, çështja e propozimit të ndërmjetësuesit në këto konteste dhe çështja e kohëzgjatjes së procedurës së ndërmjetësimin në kontestet në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme. Ndërsa për rregulloren për

kompensime të veçanta, ministri Gashi është shprehur se kjo bëhet me qëllim të krijimit të një sistemi funksional të së drejtës së autorit. "Mbajtësit e të drejtave do të kompensohen për shfrytëzimin e veprave të tyre nga ana e shfrytëzuesve të të drejtave, kështu që i propozoj Qeverisë ta aprovoj Rregulloren për rregullimin e të drejtës për kompensim të veçantë, me të cilën përcaktohen vlerat monetare - tarifa, e cila do të aplikohet për çdo mjet i cili mund të përdoret për kopjim të materialit apo lëndës të mbrojtur me të drejtën e autorit", ka thënë ministri Gashi gjatë ekspozesës për rregulloren e dytë.

Rregullorja në fjalë detajon se çfarë kompensohet. Fjala vjen, CD, DVD, disqe të ndryshme, USB, Hard disqe, për disqe të integruara, për videoregjistrues, për memorien e TV-ve e deri tek ajo e telefonave mobilë, pastaj për aparate fotokopjuese varësisht nga numri i kopjimeve që mund të bëjnë dhe për çdo kopje të bërë me pagesë, parashihen saktësisht me anë të kësaj rregulloreje. "Miratimi i rregullores është vendim historik për autorët, krijuesit dhe prodhuesit e materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit, pasi që nga sot ata do të kenë edhe një burim të të ardhurave për veprat



e tyre të krijuara me mund dhe sakrificë. Miratimi i kësaj rregulloreje përbën edhe një hap tjetër

në krijimin e një sistemi funksional të të drejtave të autorit dhe në zbatimin e obligimeve që

dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asocim", ka thënë ministri Gashi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	SANTANDER - REAL BETIS	2	ALMERIA - VILLARREAL	GG3+	CRICIUMA SC - GOIAS	1
-------------------	------------------------	---	----------------------	------	---------------------	---

Feronikeli e ruan kryesimin, Ballkani befasoi Llapin

Feronikeli i Drenasit e ka regjistruar edhe fitoren e nëntë në kampionat, pasi e ka mposhtur skuadrën rivale, Drenicën. Fitores i është gëzuar edhe Gjilani në përballje me KEK-un, ndërsa befasia të madhe ka shkaktuar Ballkani i Sami Sermaxhajt që e ka mposhtur skuadrën e Llapit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 TETOR - KF Feronikeli vazhdon ta ruajë kryesimin në elitën e futbollit të Kosovës, pasi e ka mposhtur Drenicën në ndeshjen e zhvilluar të mërkurën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas me rezultat 2-1. Skuadra vendëse ishte më e mirë dhe në fund iu gëzua tri pikëve të reja që e mbajnë në pozitën e parë në IPKO Superligë edhe pas xhiros së trembëdhjetë. Në minutën e 33-të, Carioca Da Silva shënoi për 1-0, por kuqezinjtë nuk u dorëzuan dhe pas dhjetë minutash e barazuan rezultatin në 1-1, golashënues ishte Osman Mëziu. Në pjesën e dytë, edhe përkundër dominimit të vendësve, Drenica u mbajt mirë deri në minutën e 79, kur sulmuesi kryesor i "Niki"-t, Kastriot Rexha realizoi për rezultatin final 2-1. Në xhiron e radhës Drenicën e pret një ndeshje e vështirë në stadiumin "Bajram Aliu", pasi është nikoqire e Prishtinës, kurse Feronikeli i shkon Ballkanit. Befasi të madhe në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë ka shkaktuar skuadra e Ballkanit, e



cila e ka mposhtur Llapin me rezultat minimal 0-1. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 70 Durim Gashi vulosi fitoren e mysafirëve. Pas kësaj xhiroje Llapi mbetet në kuotën e 23 pikëve dhe renditet në pozitën e tretë në tabelë, kurse Ballkani ngrihet në pozitën e tetë me 18 pikë të grumbulluara. Fitore më të lehtë ka arritur skuadra e Gjilanit që e ka mposhtur skuadrën e fun-

dit në tabelë, KEK-un (2-0). Golashënues për skuadrën e drejtuar nga Sadat Pajaziti ishin Wilber Perez në minutën e 34-t dhe Vilfor Hysa në minutën e 85-të. Gjilani ngrihet në pozitën e pestë me 20 pikë, kurse KEK-u mbetet e fundit me vetëm një pikë. Në dy ndeshjet e zhvilluara të martën Drita iu gëzua fitores në ballafaqim me Flamurtarin, kurse Liria dhe Ferizaj luajtën baras.

Prishtina e mposhti Trepçën '89 në "Fadil Vokrri"

FC Prishtina e ka mposhtur Trepçën '89 me rezultat 2-0, në ndeshjen që është zhvilluar sonte në stadiumin "Fadil Vokrri". Vendasit nga fillimi e deri në fund ishin skuadër me e mirë se kundërshtari nga Mitrovica dhe në fund më merit morën pikët e plotë. Në pjesën e parë, Mario Morina (15') u përkujdes për rezultatin 1-0. Tre minuta më vonë Morina doli sërish në rast të mirë, por nuk shënoi. Në minutën e 28-të edhe Korenica dështoi të shënoi golin e dytë. Katër minuta më vonë Arbër Hoxha tundi rrjetën e mysafirëve, por gjyqtari Dardan Çaka e anuloi golin me pretekst se Khalid kishte luajtur me dorë. Vetëm një minutë më vonë Hoxha sërish ishte në rast

ideal, por nuk gjuan si duhet me kokë. Rasti i fundit në pjesën e parë ishte ai i Morinës në minutën e 42-të që gjuan pranë shtyllës. Në pjesën e dytë mundësinë e parë e patën mitrovicasit, por gjuajtjen e Hasan Hysenit e priti Bekaj. Tre minuta më pas Prishtina ishte afër golit të dytë, por gjuajtja e devijuar e Morinës qëlloi shtyllën. Mundësi të mirë pati edhe Khalid në minutën e 65-të pas këtij asistimi të Morinës. Ndërkohë, fitoren e Prishtinës e vulosi zëvendësuesi Mërgim Pefqeli me gjuajtje të fortë. Nga minuta e 70-të Trepça mbeti me një lojtar më pak pas përjashtimit të Ylber Malokut. Pas kësaj fitoreje Prishtina ka 27 pikë, dy më pak se Feronikeli që kryeson renditjen.

SHKURT

Burri, nënkryetar i parë i FFK-së

Anëtar i Bordit Ekzekutiv në Federatën e Futbollit të Kosovës dhe ish-kryetar i KF Besa, Bakir Burri, është emëruar nënkryetar i parë i FFK-së. Këto ndryshime ende nuk janë zyrtarizuar nga Federata e Futbollit, por gazeta ka mësuar se Burri do të jetë zëvendësuesi i parë i kryetarit Agim Ademi, kurse nënkryetari i dytë do të jetë Agim Dibrani.

Ismajli lë Kosovën për Shqipërinë

Ish-kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Ardian Ismajli, pritet t'i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë. Pas mosftesës nga përzgjedhësi i përfaqësueses A të Kosovës, Bernard Challandes, mbrojtësi 22-vjeçar i Hajdukut të Splitit është pajisur me pasaportën e Shqipërisë dhe në muajin nëntor pritet ta marrë edhe ftesën zyrtare nga përzgjedhësi i kuqezinjve, Christian Panucci.

Messi rikthehet në stërvitje

Barcelona pas fitores ndaj Real Madridit (5-1) sot e ka marrë edhe një tjetër lajm të mirë. Bëhet fjalë për rikthimin e Lionel Messit në stërvitje. Lajmin e konfirmon faja zyrtare e klubit spanjoll. Messi qëndroi jashtë fushës për dhjetë ditë, pasi pësoi lëndim në ndeshjen ndaj Sevillas (4-2). Argjentinasi nuk pritet të luajë në fundjavë, por në mesjavën e ardhshme në Ligën e Kampionëve kundër Interit.

Saraqiq më i miri në turneun memorial të shahut "Mustafë Ibrahimit"

Për ta përkujtuar dhe nderuar figurën e patriotit dhe veprimtarit për çështjen kombëtare, njeriun e arsimit, ekonomistin, ish të burgosur politik, së fundi edhe punëtorin e vyeshëm NLB Bank, Mustafë Ibrahimit, u mbajt turneu i gjashtë, tani tradicional përkujtimor "Mustafë Ibrahimit", nën organizimin e NLB Bank. Ky turne u organizua në ambientet e Sallës së Federatës së Shahut të Kosovës. Garat u zhvilluan sipas sistemit (13 xhiro, 3 min + 2 sec sipas rregullave të FIDE). Për më të mirët u shpërndanë kupa, medalje, premi, diploma e shpërblime dhe mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit. Vendi i parë i takoi Nderim Saraqiq, kurse vendi i dytë Gani Hamitit. Në pozitat e tjera vijuese u renditen Bedri Sadiku, Sulejman Suljeviq, Ardian Jashari dhe Përparim Makolli.

KF Ferizaj dënon sulmin ndaj lojtarit të Llapit

Kryesia e klubit të Ferizajt ka mbajtur mbledhje pasi e ka kuptuar se çfarë ka ndodhur në ndeshjen e juniorëve në mes të Ferizajt dhe Llapit, ku mbetet të sulmuar lojtarët llapanë. Ferizajasi kanë dënuar ashpër sulmin fizik si pasojë e të cilit një lojtar përfundoi në spital. "Klubi njëzëri e dënon ashpër sulmin ndaj lojtarit të Llapit, Arbresh Aliu dhe kërkon nga autoritetet që t'i gjejnë dhe t'i dënojnë ata që e shkaktuan këtë. Ferizaj është i interesuar që loja e futbollit të shkojë në frymën e 'fair-play' dhe kundërshton çdo lloje dhune në sport. Klubi i dëshiron shërbim sa më të shpejtë lojtarit Arbresh Aliu, duke i uruar fat në karrierën e klubit të Llapit dhe gjithmonë mirëseardhje në qytetin e Ferizajt", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

IPKO Superliga

Feronikeli - Drenica	2-1
Llapi - Ballkani	0-1
Gjilani - KEK-u	2-0
Flamurtari - Drita	0-1
Liria - Ferizaj	0-0
Prishtina - Trepça '89	2:0

Tabela

	PIKË	
1. Feronikeli	12	29
2. Prishtina	11	24
3. Llapi	13	23
4. Drita	13	22
5. Gjilani	12	20
6. Flamurtari	13	19
7. Drenica	13	18
8. Ballkani	13	18
9. Trepça '89	12	15
10. Ferizaj	12	11
11. Liria	13	10
12. KEK-u	12	1

Në xhiron e radhës takohen: Drenica-Prishtina, Ballkani-Feronikeli, KEK-u-Flamurtari, Trepça '89-Gjilani, Ferizaj-Llapi, Drita-Liria.

Kampionati Botëror i Katarit mund të rritet në 48 shtete

NYON, 31 TETOR - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka bërë me dije se Kupa e Botës mund të rritet në 48 shtete për Botërorin e Katarit që mbahet në vitin 2022. 48 shtete e kanë konfirmuar tashmë pjesëmarrjen në Botërorin e vitit 2026, i cili do të zhvillohet në ShBA, Kanada e Meksikë, por Infantino ka shprehur interesim në rritje, pse jo edhe më herët. "Nëse do të ishte e mundur, pse jo. Duhet t'i

shohim mundësitë. Jemi duke folur me shokët nga Katari, jemi duke folur edhe me shumë shokë në rajon dhe shpresojmë që kjo të ndodhë. Nëse jo, të paktën do të provojmë. Duhet të provojmë, sepse

ne gjithmonë dëshirojmë t'i bëjmë gjërat në mënyrën më të mirë", ka deklaruar Infantino. Ky ndryshim, po ashtu, do të kërkonte nga Katari që zhvillimi i Botërorit të bëhej edhe në shtetet e tjera në rajon.

ne gjithmonë dëshirojmë t'i bëjmë gjërat në mënyrën më të mirë", ka deklaruar Infantino. Ky ndryshim, po ashtu, do të kërkonte nga Katari që zhvillimi i Botërorit të bëhej edhe në shtetet e tjera në rajon.



Clevelandi shijon fitoren e parë

OHIO, 31 TETOR - Pas 6 humbesh vjen fitorja e parë në kampionat për Clevelandin, ekipi nënkampion i NBA-së, që triumfoi 136-114 ndaj Atlantës, ndeshje me rivalitet në pjesën e parë, por në të dytën cavaliersat dominuan në parket. 7 lojtarë të Clevelandit realizuan mbi 11 pikë, me Hoodin që ishte shënuesi më i mirë me 26 pikë. Vijon të zhgënjëjë skuadra e Houstonit, që regjistroi humbjen e pestë sezonale (ka vetëm një fitore). Teksanët u mundën 104-85 nga Portlandi, që e dominuan takimin dhe merituan fitoren (Lillardit e Nurkiqi realizuan nga 22 pikë secili).

Rikthehet te fitorja skuadra e Torontos, një nga ekipet pretendente në Lindje, pas fitores 129-112 ndaj Philadelphias. Sfidë e komanduar nga kanadezët, me të zakonshmin Leonard që është lider në fushë, duke realizuar 31 pikë, ndërsa 31 pikët e Embiid për miqtë mbetën për statistikë. Fitoren e dytë sezonale korri ekipi i Oklahomës, që mundi 128-110 Clippersin, sfidë që u vendos në periodën e fundit në favor të ekipit vendës. Westbrook dhe George realizuan nga 32 pikë secili, duke qenë vendimtarë në fushë për ekipin e Thunderit, raporton "Telesporti". Fiton edhe skuadra e Bostonit, që mundi në sekondat e fundit 108-105 Detroitin, një tjetër përballje me rivalitet mes dy



ekipeve që synojnë play off-in në Lindje. Irving me 31 pikë bëri diferencën në parket për Celticsin, duke i bërë të pavlefshme 24 pikë e 15 rebaunde të Griffinit për miqtë. Skuadra e Charlottes, falë 24 pikëve të veteranit Tony Parker, mundi 125-113 Miamin, ndeshje ku për vendësit ishte stoli ai që bëri diferencën (66 pikë). Memphis mposhti 107-95 Washingtonin, ndeshje ku u dalua Temple me 20 pikë, ndërsa Sacramento mundi 107-99 Orlando (Hield 25 pikë e 11 rebaunde).

REZULTATET

Charlotte - Miami	125-113
Cleveland - Atlanta	136-114
Orlando - Sacramento	99-107
Boston - Detroit	108-105
Toronto - Philadelphia	129-112
Houston - Portland	85-104
Memphis - Washington	107-95
Oklahoma - Clippers	128-110

Ronaldo te Juventusit e thyen një rekord 61-vjeçar

TORINO, 31 TETOR - Cristiano Ronaldo la Realin e Madridit për t'u transferuar te Juventusit verën që shkoi. Ishte një sfidë e re për portugezin, i cili donte t'i shpaloste vlerat në një tjetër kampionat të madh, pasi kishte luajtur në Angli dhe Spanjë. Sigurisht se pritshmëritë për të janë të mëdha dhe me interes pritet që të shihet se cilat do të jenë rekordet që do të thyejë 33-vjeçari në Torino. Ishin pikërisht dy golat e realizuar në ndeshjen e fundit me Empolin, që i regjistruan rekordin e parë sulmuesit. Ronaldo ka shënuar 7 gola në 10 ndeshje, një statistikë që te Juventusit ishte regjistruar 61 vjet më parë. Saktësisht në vitin 1957, kur uellsiani Xhon Çarls la Leedsin dhe që në sezonin e parë arriti që të shënonte 25 gola. Premisat janë që Ronaldo ta tejkalojë këtë numër, por fakti që ka shënuar 7



gola në 10 ndeshje e bën atë të veçantë, pasi para tij nuk e kishin arritur as emra si Del Piero apo Ibrahimoviqi.

SHKURT

Gjimshiti mund të largohet nga Atalanta

Berat Gjimshtiti duket se po kërkon një ekip ku të mund të luajë më shumë. Mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare është aktivizuar pak me Atalantën këtë sezon. Klubi i tij i ka ofruar rinovimin, por duket se ai do të largohet. Sipas medieve italiane, e interesuar për qëndrmbrojtësin është Frosinone, e cila po lufton për të qëndruar në Serinë A. Përforcimi i mbrojtjes shihet si një mundësi më shumë për të qëndruar mes më të mirave për ekipin që mban vendin e 19 në Serinë A. Sipas të gjitha gjasave, në janar Gjimshtiti do të ndërrojë destinacion.

Platini: Varane duhet ta fitojë 'Topin e Artë'

Ish-presidenti i UEFA-s, Michel Platini, ka thënë se qëndrmbrojtësi i Francës dhe Real Madridit, Raphael Varane, duhet ta fitojë "Topin e Artë". "Një francez do ta fitojë Topin e Artë. Gjithmonë ekziston debati Ronaldo-Messi, por këtë vit e kemi vetëm një futbollist i cili e ka fituar Ligën e Kampionëve dhe Kupën e Botës. Ai është Varane. Përveç kësaj, ai është lojtar i shkëlqyer, për të cilin do të kisha votuar edhe unë. Rezultatet janë e vetmja gjë objektive, çdo gjë tjetër është subjektive", ka thënë Platini.

Bayerni, 100 milionë për Dybalan

Bayern Munchen është gati të ofrojë 100 milionë euro për Paulo Dybalan e Juventusit. Lajmi është bërë me dije të mërkurën nga "Corriere di Torino". Bayerni nuk ka shpenzuar asnjëherë më shumë se 42 milionë euro për transferimin e një futbollisti, por duket se gjigantët gjermanë duan që të jenë konkurrentë me skuadrat e mëdha evropiane, prandaj për të bërë një gjë të tillë duhen shpenzuar edhe shuma të mëdha.

Griezmanni ëndërron "Topin e Artë"

Ylli i Atletico Madridit, Antoine Griezmann, e pranon se ëndrra e tij është që ta fitojë "Topin e Artë". Francezi preferon suksesin ekipor, por fitimi i "Topit të Artë" do të ishte një ëndërr e bërë realitet. 27-vjeçari është në mesin e kandidatëve për të fituar këtë çmim pas triumfit në Ligën e Evropës me Atletico Madridin dhe triumfit në Kupën e Botës me Francën. "Nuk kam frikë që ta them. Unë ëndërron për 'Topin e Artë'. Për Ligën e Kampionëve, për fitimin e Kupës së Botës. Unë ëndërron për shumë gjëra. Ëndërron që të kem tre fëmijë. Këto ëndrra të motivojnë kur të zgjohesh çdo mëngjes dhe të kesh objektiva për të arritur", ka deklaruar Griezmanni.

Simona Halep shpallet tenistja vitit

Tenistja rumune Simona Halep është shpallur nga WTA (Women Tennis Association) si "Tenistja më e mirë e vitit 2018", vit të cilin ajo e mbylli në krye të renditjes botërore. Këtë vit Halep arriti ta fitojë grand slam-in e parë në karrierën e saj, atë të Roland Garros, ndërsa në Australian Open u mund në finale. Ajo ndodhet në krye të renditjes botërore prej 40 javësh. Një çmim mori edhe Serena Williamsi, tenistja 36-vjeçare amerikane, që u vlerësua si "Rikthimi i vitit", ndërsa holandezja Kiki Bertens u vlerësua me çmimin "Tenistja me progresin më të madh". Tenistja bjelloruse Aryna Sabalenka mori çmimin "Tenistja surprizë e vitit". Në lojën dyshe, tenistet më të mira femra të vitit 2018 u shpallën Barbora Krejčíková dhe Katerina Siniakova.



Republic of Kosovo
Government
Ministry of Education, Science and Technology

Kosovo Education Systems Improvement Project (KESIP)

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST

Project Number: P145009 Credit No: IDA 5760

Assignment Title 1: **Procurement Expert/Specialist**
Reference No: **XK-MEST-73902-CS-INDV**

I. BACKGROUND

The Government of Kosovo has received a World Bank Credit to implement an Education Systems Improvement Project (ESIP). The project is approximately US\$11 million equivalent and aims at supporting the education sector reforms in Kosovo in order to (i) improve the Strategic and financial planning and monitoring capacity for decentralized education system; (ii) improve and strengthen teacher management and certification; (iii) provide support for the strengthening and improvement of Kosovo's student assessment and examination system; and (iv) strengthening Education Monitoring and Evaluation Capacity and Implementation and Communications Support.1

The project is organized in two main components and their sub-components as shown below:

Component 1 aims to improve the strategic and financial planning and monitoring capacity for decentralized education system. The sub-components are: 1.1 Strengthening strategic planning and financial management capacities; 1.2 Enhancing the existing Education Management Information System (EMIS); and 1.3 School Development Grants.

Component 2 aims to improve and strengthen teacher management and certification system and facilitate the use of international best practices in assessing the quality of education and certification. Its sub-components are: 2.1 Implementation and Improvements to the Teacher Career System; 2.2 Strengthening capacities of key institutions for monitoring educational outcomes and assessment of student learning; and 2.3 Improving accountability and quality assurance of higher education through the development of key professional licensing statutes in priority economic fields.

The Ministry of Education, Science and Technology (MEST) is responsible for the overall implementation of the project, the prioritization and preparation of the annual activity plans, and the coordination of various activities in the Project across different departments, municipalities, and school. The General Secretary of MEST is responsible for coordination and monitoring of activities at a technical level. Under the supervision of the General Secretary, the Project Coordination Unit (PCU), consisting of the Project Coordinator, Procurement Specialist, Financial Management Officer, and additional support staff, is responsible for the day-to-day implementation of the Project. The PCU is headed by an externally-hired Project Coordinator

The MEST/PCU through this specific advertisement and recruitment process intends to engage a highly qualified consultant (individual expert) to provide services as a full time Procurement Expert/Specialist.

II. OBJECTIVE OF THE ASSIGNMENT

The key objectives of this assignment are to assist the Project and MEST to carry out Project related procurement activities observing procurement procedures applicable to the ESIP operation and to strengthen procurement capacity of institutions involved in the Project implementation.

The Procurement Expert (PE) will assist the Project Coordinator (PC) to manage the flow of procurement activities scheduled for ESIP.

The PE shall ensure that all Procurement processes under the Project are carried out in accordance with World Bank "Guidelines: Procurement of Goods, Works, and Non-Consulting Services under IBRD Loans and IDA Credits and Grants by World Bank Borrowers" dated January 2011 revised in July 2014; and "Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits and Grants by World Bank Borrowers" dated January 2011 revised in July 2014, and the provisions stipulated in the Legal Agreement. The World Bank Guidelines on Preventing and Combating Fraud and Corruption in Projects Financed by IBRD Loans and IDA Credit and Grants dated October 15, 2006 and revised on January 2011, will also apply. The Bank Standard Bidding Documents, including evaluation for procurement of works and goods will be used, and the Bank's Standard Request for Proposal for selection of consultants, including the standard evaluation report. He/she will, as necessary, work closely with the component advisors, project staff and consultants to help them understand the details of the procurement aspects of the project implementation.

III. SCOPE OF WORK

Duties and Responsibilities

Principal functions of the Procurement Expert will include the following:

- In cooperation with the MEST Procurement Section to establish and maintain an information database on procurement services, technology services, suppliers of equipment, consultants, etc.;
- Conduct training for education institutions on procurement in accordance with the Project Operational Manual (POM) provisions and schedules specified in the annual program and ensure consistency with the POM provisions;
- Maintain reporting procurement system in accordance with the POM provisions;
- Set up a monitoring capacity within the entities for overseeing project procurement actions and coordinating necessary approvals or correcting shortcomings in procedures or conclusions.
- Assist MEST with updating the Procurement handbook for the school grants and as needed the procurement Section of the Procurement Manual.

- Approve the procurement plans as a final document from School Improvement Grants project proposals in accordance with the POM and School Improvement Grants Procurement Handbook;
- Procurement of goods, works and services conducted in accordance with the provisions of the World Bank Guidelines and POM;
- Preparing Contracts for Consultants, Goods and non-consultant Services;
- Responsible for monitoring of Contracts realizations;
- Updating regularly and maintaining detailed annual Procurement Plan for the Project;
- Include all required procurement information in the Bank's STEP system for the Project;

In general, the specific tasks to be undertaken by the PE should cover the complete procurement cycle. This will include but not be limited to:

- Check/prepare the Bidding Documents (BDs) / Request For Proposals (RFP) using the World Bank respective formats; thoroughly reviewing all bidding documentation prior to submission to the World Bank in timely fashion and clearing them with the Bank;
- In coordination with the Project Coordinator, prepare notifications for advertising contracts – General Procurement Notices (GPN), Specific Procurement Notices (SPN) and Requests for Expressions of Interest (EOI) and clear them with the Bank;
- All procurement process shall be conducted using the STEP system, for both prior and post review contracts;
- Ensure that the procurement process is conducted in accordance with the Procurement Plan and in line with provisions the World Bank Procurement Guidelines and Consultants Guidelines;
- Ensure that contracts for works, goods and consulting services are prepared based on the draft contracts included in the BDs/RFP, using the World Bank formats; he/she will monitor contract implementation, in order to ensure the contract implementation is conducted as per the schedule in the Procurement Plan, and the assignment is carried out in accordance with the terms and provisions of the signed contract;
- Record the times of delivery of Bids and Requests For Proposals, and keep all necessary records;
- Oversee the opening of Bids and Requests For Proposals in a timely manner and prepare of the minutes of bid (or proposals) opening;
- Assist the evaluation committee to ensure that evaluations are conducted in accordance with the criteria stipulated in the bidding documents;
- Prepare all necessary evaluation reports and award recommendations on behalf of the evaluation committee, and submit the evaluation reports to the Bank for no objection, through PC. Assist the PC to conduct contract negotiations with consulting firms and prepare the draft negotiated contract; contracts for award;
- Ensure that all procurement documentation for which the Bank's prior No-Objection is required, is prepared and submitted, in accordance with the Bank's Procurement Guidelines;
- Provide guidance to PC on all procurement related issues;
- Assist the PC on preparation of the correspondence with bidders during the bidding process, or during contract implementation;
- Prepare maintain and keep updated, the Procurement Plan in close collaboration with the PC; and assist the PC on revising /adjusting the Procurement Plan as needed during the life of the Project (i.e. updating the procurement plan twice a year and whenever requested by the Bank);
- Certify (jointly with the beneficiaries' representatives) the acceptance of the goods and services provided in accordance with the terms of reference, contracts and the relevant technical specifications;
- Assist in the preparation of the project progress reports; verification of payment documents under contracts for the supply of goods, and services; and contract closure procedures and final reporting;
- Any other procurement-related duty as may be requested by the Project Coordinator.

IV. QUALIFICATIONS

1. Minimum requirements:

- University degree in economics, management, law or equivalent;
- At least 3 years' experience working with international organizations such as the World Bank or other donor funded projects in procurement management;
- Be Fluent in Albanian and English languages;
- Excellent communication and team working skills;
- Computer literate. Good knowledge of MS Office applications.

2. The desirable/advantage skills:

- Practical experience with grant management (procurement aspects) is an advantage;
- Experience in projects or organizations with large budgets and purchasing of services/products;

V. SELECTION, LEVEL OF EFFORTS AND DURATION

The work of the PE will be on full time bases. PE will be selected and contracted in accordance with the procedures set out in the provisions of Regulation of Ministry of Finance -No. 05/2017 on the Amendments of Regulation MF-NO. 01/2016 on the Management of Borrowing Funds, supplemented and amended by regulations.

All terms and conditions for this assignment will be described in the contract.

VI. REPORTING OBLIGATIONS

The Procurement Expert will report to and work under the direction of the ESIP Project Coordinator. S/he will deliver: a) regular progress report; b) monthly updated Procurement Status Report and c) final report. S/he will coordinate activities with the Project Assistant and Financial Expert of ESIP. S/he will support the Financial Expert in updating the: a) quarterly Project Disbursement Report and b) Project Disbursement Plan in coordination with the Project Coordinator.

The Consultant will keep accurate records of his/her time spent on the Project and his/her expenses (as authorized in the contract).

Prior to each payment, Project Coordinator, needs to approve the quality of the work carried out by the Consultant. S/he will communicate on a regular basis with the Project Coordinator and other relevant stakeholders.

Assignment Title 2: **Financial Management Specialist/Officer**
Reference No: **XK-MEST-74173-CS-INDV**

I. BACKGROUND

The Government of Kosovo has received a World Bank Credit to implement an Education Systems Improvement Project (ESIP). The project is approximately US\$11 million equivalent and aims at supporting the education sector reforms in Kosovo in order to (i) improve the Strategic and financial planning and monitoring capacity for decentralized education system; (ii) improve and strengthen teacher management and certification; (iii) provide support for the strengthening and improvement of Kosovo's student assessment and examination system; and (iv) strengthening Education Monitoring and Evaluation Capacity and Implementation and Communications Support.2

The project is organized in two main components and their sub-components as shown below:

Component 1 aims to improve the strategic and financial planning and monitoring capacity for decentralized education system. The sub-components are: 1.1 Strengthening strategic planning and financial management capacities; 1.2 Enhancing the existing Education Management Information System (EMIS); and 1.3 School Development Grants.

Component 2 aims to improve and strengthen teacher management and certification system and facilitate the use of international best practices in assessing the quality of education and certification. Its sub-components are: 2.1 Implementation and Improvements to the Teacher Career System; 2.2 Strengthening capacities of key institutions for monitoring educational outcomes and assessment of student learning; and 2.3 Improving accountability and quality assurance of higher education through the development of key professional licensing statutes in priority economic fields.

The Ministry of Education, Science and Technology (MEST) is responsible for the overall implementation of the project, the prioritization and preparation of the annual activity plans, and the coordination of various activities in the Project across different departments, municipalities, and school. The General Secretary of MEST is responsible for coordination and monitoring of activities at a technical level. Under the supervision of the General Secretary, the Project Coordination Unit (PCU), consisting of the Project Coordinator, Procurement Specialist, Financial Management Officer, and additional support staff, is responsible for the day-to-day implementation of the Project. The PCU is headed by an externally-hired Project Coordinator.

The MEST/PCU through this specific advertisement and recruitment process intends to engage a highly qualified consultant (individual expert) to provide services as a full time Financial Management Specialist/Officer.

II. OBJECTIVE OF THE ASSIGNMENT

The key objective of this assignment is to assist ESIP and MEST line departments responsible for each priority in carrying out financial management responsibilities in accordance with provisions stipulated in Financing Agreement between IDA (World Bank) and MEST and procedures described in the POM.

III. SCOPE OF WORK

Duties and Responsibilities:

The Financial Management Specialist (FMS) will be responsible for the following tasks:

- In cooperation with MEST Budget and Finance Department, establish and maintain the financial management systems as required in the Credit Agreement;
- Execute all necessary work related to accounting, disbursements, payments, cash registry in coordination with MEST and the Ministry of Economy and Finance (MEF).

In general, the specific tasks to be undertaken by the consultant will include but not be limited to:

- Updating the Project Operational Manual, FM part, as needed;
- Maintaining the financial records and accounts;
- Preparing the interim financial management reports to the Bank to relevant government agencies and ministries including the narrative part of the report;
- Reviewing, verifying and processing for approval all request for payments of project expenditures financed from IDA Credit and if applicable, government contributions and other donors funds, if any;
- Ensuring timely execution of payments to suppliers, contractors and consultants in accordance with contract conditions;
- Ensuring accurate project accounting records are maintained in the Free Balance Treasury system, and verifying accuracy and completeness of all transactions;
- Ensuring that reliable and effective internal control environment is maintained within the PCU in line with the Project Operational Manual;
- Preparing the quarterly Interim Un-audited Financial Reports and annual project financial statements and submission of these reports to the World Bank on a timely basis;
- In cooperation with Procurement Specialist, preparing the quarterly Financial Management Report as part of the Procurement Status Report and submission of this report on a timely basis;
